VENDIM
Nr. 473, datë 3.6.2015

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 276, DATË 1.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES DHE MINISTRIT TË SHTETIT PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE, TË PRONËS NR. 33, ME EMËRTIM "SHTËPIA E USHTARAKËVE", ME VENDNDODHJE NË BULEVARDIN "ZHAN D'ARK", TIRANË, PËR VENDOSJEN E QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT (QKR), QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT (QKL) DHE QENDRËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 276, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në titull dhe në pikën 1 bëhen këto shtesa:

a) Pas emërtimit "... ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike ..." shtohen fjalët "... si dhe ministrit të shtetit për Çështjet Vendore ...".

b) Pas emërtimit "... Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)" shtohen fjalët "... si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM) e Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale (AZRT)".

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes t'i jepet, në përdorim të përkohshëm, trualli funksional i pronës, bodrumi, kati përdhes, kati i parë, i dytë, i tretë dhe i katërt i godinës, sipas planvendosjes dhe planimetrive, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për sistemimin e administratës së Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM). Ndarja e mjediseve të jetë, si më poshtë vijon:

a) Bodrumi të përdoret nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR), Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM) dhe nga Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).

b) Kati i parë dhe kati i tretë të përdoren nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR).

c) Kati i dytë të përdoret nga Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM).

ç) Kati i katërt të përdoret nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL).".

3. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore t'i jepet në përdorim të përkohshëm kati i shtatë i godinës, sipas planimetrive dhe planvendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për sistemimin e administratës së Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale (AZRT).

Një pjesë e kësaj hapësire të katit të shtatë të përdoret nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR), Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM), Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale (AZRT), si ambient i përbashkët për të zhvilluar takime dhe mbledhje pune.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Planimetri e katit **nëntokë (QKR)** - Sh. 1:175*



LEGJENDE

— Mure qe ruhen
— Mure gipsi qe shtohen
— Mure tulle qe shtohen
— Mure qe shemben

—Vetrata/dyer qe ruhen
—Vetrata/dyer qe shtohen
Vetrata/dyer qe hiqen

Modifikime krahasuar me planimetrite e 06.04.2015

07.04.2015


Planimetri e katit **përdhe (QKR + QKL) -** Sh. 1:175*
LEGJENDË
Mure që ruhen
Mure gipsi që shtohen
Mure tulle që shtohen
Mure që shemben
Vetrata/dyer që ruhen
Vetrata/dyer që shtohen
Vetrata/dyer që hiqen
Modifikime krahasuar me planimetrite e datës 06.04.2015
07.04.2015

Planimetri e katit **të parë (QKR)** - Sh. 1:100



07.04.2015

Planimetri e katit **të dytë (QKR)** - Sh. 1:100

07.04.2015


N
PIANO SESTO
BASHKIA TIRANE
CARCERANO s.p.a.


N
PIANO TERRAZZA
BASHKIA TIRANE
CARCERANO s.p.a.